




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 11.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **08.03.2019**, të parashtruar nga OE "TALI" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Gjilanit** " me nr të prokurimit **651-20-5015-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 058 521** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomikë OE "TALI" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Gjilanit** ", me nr të prokurimit **651-20-5015-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 058 521** e dt. **08.03.2021** kundër Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës **07.09.2021** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjilanit vendos të vazhdojë sipas** Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës **03.03.2021**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë OE "TALI" SH.P.K. me datë **08.03.2021** , ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Gjilanit** ",

me nr të prokurimit 651-20-5015-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 20 058 521. Autoriteti Kontraktues me datë 10.03.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë të datës 07.09.2021 më saktësisht tek Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar si dhe tek Kapaciteti teknik dhe profesional :

Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

Dëshmia 3. OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj listën e pasjeve duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit dhe duhet te bashkëngjis Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen me validitet. Shfrytëzim Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar në prezence të qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Në pretendimin Ankimor nga ana juaj si OE specifikohet :

Kompaninë që keni eliminuar me datën 08.12.2020 për arsye se nuk i ka plotësuar kriteret e cekura në Dosje të Tenderit të njëjtën keni shpallur fituese me 03.03.2021. Dhe pasi që kemi pasur qasje në dokumentacionin e OE fitues kemi hasur dhe në Marrëveshjen EL – Bau dhe Avag Group për mekanizëm ku dy kompanitë kanë aplikuar në të njëjtin projekt. Ku me ligj nuk lejohet të aplikohet me mekanizmin e njejt dy Kompani të ndryshme.

Ne si AK – Autoritet Kontraktues kemi udhëhequr procedura në bazë të LPP-së ku Ligji i Prokurimit ju jep të drejtën të gjithë OE që të ofertojnë në mënyrë të barabartë. Rrjedhimisht, ligji nuk e ndalon që më shumë se një OE të ketë në këtë rast Marrëveshjen e njejtë për mekanizëm.

Gjithashtu, duke u bazuar në Vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit me datë 26.01.2021. Ku, ky i fundit ka Aprovuar Ankesën e OE “ Avag Group & Eing Com “ Sh.p.k. Dhe ne si AK duke respektuar Vendimin me OSHP-së kemi vazhduar me procedura të mëtutjeshme.

Ne baze te nenit 17 të Rregullores për Prokurim Publik:

1. Autoriteti kontraktues konsiderohet se **ka respektuar vendimin e OSHP-se** nëse ka bere një proces ri-vlerësimi (kur vendimi i OSHP-se e ka kërkuar këtë) duke marre për baze vendimin e OSHP-se lidhur me pretendimet e bëra ne ankese.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 11.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimet ankimore (neni 113 i LPP-së)

- Sa i përket **Pretendimit Nr. 1** të Grup i Operatorëve Ekonomik "AVAG GROUP & EING COM" shpk se padrejtesisht është eliminuar për shkak udhëheqësi i punishtes z. Valon Latifi si Bachelor i Ndërtimtarisë nuk i k katër vite përvojë profesionale pas diplomimit.

Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që AK pa te drejtë e ka eliminuar operatorin ekonomik ankues, i cili ka ofertuar me çmimin me te lirë.

Faqe 2 nga 6

AK – Komuna e Gjilanit ne Njoftimin për Kontrate dhe ne Dosje te tenderit, kriterin e ka përshkruar ne mënyrë jo te kjarhtë "Udhëheqës i punishtes Inzhinier ose bachelor i dëp. i ndërtimtarisë, drejtim konstruktiv, ose infrastrukturë rrugore me se paku katër (4) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit)."

Ne këtë rast kur numri (1) është i vendosur ne parantezë qe e definon kuptimin e tekstit te shënuar para numrit. Forma si është shënuar ky kriter nga AK, ka krijuar paqartësi tek OE ofertues dhe mundësi qe ata te bien në lajthitje, për çka OE nuk janë fajtor për këtë gjë dhe nuk mund te dëmtohen për gabimet e AK. Ne rastin konkret AK – Komuna e Gjilanit, duke marrë parasysh se kriterin e ka shënuar ne mënyrë jo te drejtë, është dashtë qe ne përputhje te Nenit 72 te LPP-se te kërkoj sqarime shtese nga OE ankues, nëse ky operator disponon me ndonjë inzhinier tjetër shtesë te këtij profili dhe me eksperience me te madhe për ta plotësuar kriterin e tenderit.

Oferta e OE te rekomanduar është rreth 400% me e shtrenjte se sa oferta e OE ankues.

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Izet Kurteshi

Menaxher i zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.